

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 3 SHKURT 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Ditën e premte në Komisionin e Ligjeve erdhi nënë Liza me shumë hijeshi, me shumë më shumë hijeshi se disa kolegët tanë, për të folur dhe për të paraqitur pretendimet banorëve të “5 Majit”. Priti me durim dhe i tregoi publikisht shqetësimet e pretendimet e saj: “Shteti më ka cenuar të drejtën e pronës dhe më ka keqtrajtuar, ndërsa jam përpjekur ta mbroj atë”. Ky ishte, pak a shumë, thelbi i dëshmisë së nënë Lizës. Tre përfaqësuesit e 136 familjeve të prekura nga programi i rindërtimit rrëfyan me indinjatë të gjitha pretendimet e tyre për parregullsinë e procesit të njoftimit të shpronësimit, për pasiguritë juridike të aktmarrëveshjes dhe për ndërhyrjen e dhunshme të policisë.

E respektoj nënë Lizën dhe djemtë e “5 Majit” që mbronin të drejtat dhe pronën e tyre, respektoj dhe mirëkuptoj tërësisht sakrificën që duhet të bëjnë në këtë kohë të ftohtë të vitit për hir të një projekti që nuk është as i lehtë dhe as pa pasoja në realizimin e tij. Ajo që nuk arrita të premtën, por as sot, të kuptoj është përdorimi me çdo kusht dhe në çdo rrethanë i vështirësive që krijohen sa herë që ne duhet të kalojmë e të zbatojmë projekte të mëdha publike në të mirë të këtij qyteti, në të mirë të qytetarëve të këtij qyteti. Nuk i kuptoj dot banorët e “Shtëpisë së Lirisë” që i hidhnin benzinë zjarrit të zemërimit të përzgjedhur ndaj shtetit. A thua se strehimi i familjeve të prekura nga tërmeti nuk është detyra jonë e përbashkët?! A thua se transformimi i kaosit urbanistik dhe shoqëror nuk është përfitim i të gjithë publikut?! A thua se rrugët, kanalizimet, ndriçimi, shkollat, çerdhet, kopshtet, parqet, shërbimet administrative në atë qendër moderne banimi nuk do të rishpërndahen si të mira urbane për të gjithë banorët?! A thua se nxitja e zhvillimit ekonomik në atë zonë do të jetë privilegj i disave dhe jo realitet për të gjithë banorët e asaj zone, ose, siç thuhet në Pezë, janë pa dallim feje, krahine e ideje?! A thua se rregullimi i çështjeve të pronësisë do të jetë premtimi politik i radhës dhe jo detyrimi ligjor për të gjithë banorët e asaj zone informale?! Interesi publik që, fatkeqësisht, u la jetim nga kolegët e opozitës në sallën e Komisionit të Ligjeve edhe sot nuk mund të jetë shumatore interesash individuale që në rastin konkret matet me 45 mijë metra katrorë banim, shërbime, truall në lagjen e re “5 Maji”!

Në udhëtimin profesional shpronësimit dhe të drejtën e pronësisë i kam parë të rrinë urtë pranë njëra-tjetrës vetëm në letrën e nenit 41 të Kushtetutës, sepse, sa herë që janë ballafaqohen në jetën e vërtetë, ka tension në rrugë, në lagje, në sheshe, në fshatra, në qytete, madje shtete. Pavarësisht tensionit që krijon, shpronësimi publik është i vetmi institut, ku drejtpeshohet respektimi i të drejtës së pronës dhe i interesit publik, thënë ndryshe, ku ekuilibrohet shteti. Ndaj, deri tani nuk kemi parë ndonjë sistem kushtetues që ta ketë hequr qafe. Nënë Lizës dhe djemve të “5 Majit”, në zbatim të aktit normativ të rindërtimit nr. 9/2019, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave të datës 22.09.2021 “Për shpronësimin”, si dhe në zbatim të kontratës tip të miratuar nga Këshilli Bashkiak i këtij qyteti, u janë ofruar respektivisht 353,4 m² dhe 303,4 m² në lagjen e re moderne. Aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë qartë dhe shkoqur se banorët do të shpërblehen me sipërfaqet e banimit që u takojnë, ose kundërvlerën e tyre monetare dhe, ndërkohë që ndodh zhvillimi i zonës, u paguhet qiraja e banesës sipas çmimit të tregut. Këto garanci i kanë shtyrë 51 familje, 27 me dokumente

pronësie dhe 24 që zotërojnë ndërtime informale, të nënshkruajnë aktmarrëveshjen përkatëse me Bashkinë e Tiranës. Janë të njëjtat garanci që shpërblyen mbi 3 mijë familje në Vaqarr, në Thumanë, në Laç, në Bubq, në Kavajë dhe në Kurbin, që tashmë i janë rikthyer jetës në një shtëpi më të mirë, më të bukur dhe me më shumë vlerë monetare. Këto garanci i ofron e i mbron shteti ligjor. Tani për profesorin dhe për të gjithë profesorët, të vetmit të humbur në këtë mesele do të jenë banorët e “Shtëpisë së Lirisë”, të cilët janë kthyer në shtëpinë e fantazmave politike me marifetin e radhës. Po yshtin qytetarët për kapital politik, por është e provuar se, kush ndërsen të tjerët kundër ligjit dhe të mirës së të gjithëve, nuk i fshihet dot as ndëshkimit të drejtësisë dhe as verdiktit popullor në kutinë e votimit. Kur tymi i sherrit të radhës të davaritet, Tirana do të ketë fituar një lagje “5 Maji” më të mirë, më të bukur dhe më të drejtë se e sotmja, kurse Shqipëria do të vazhdojë të jetë shtëpia e vërtetë e njerëzve të thjeshtë të këtij vendi, ndërkohë që “Shtëpia e Lirisë” do të mbetet fatkeqësisht e palegalizuar. Faleminderit!